

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

**27.07.2024
Ora 11:00**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e orarit të votimit, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Znj. M. Çelmeta, znj. M. Koja. |

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme, ora 11.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në mbledhjen e sotme kemi një projektvendim, i cili vjen në kuadër të disa vendimeve të tjera të miratuara nga ana jonë, lidhur me zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht. Projektvendimi “Për miratimin e orarit të votimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

gusht 2024". Duke qenë që data e zgjedhjeve është jashtë dy periudhave zgjedhore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, do të duhet të miratohet një orar votimi. Projektvendimi ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Por para se të fillojmë me projektvendimin, doja të pyesja kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë? Zonja Vukaj! Doni ta lini për tani në fillim apo në...

Znj. H. Vukaj: Disa çështje të shkurtra, kështu që po...

Znj. I. Nano: Dakord!

Znj. H. Vukaj: ... po nuk qe problem i ezaurojmë tani.

Znj. I. Nano: Dakord!

Znj. H. Vukaj: Në lidhje me kërkesat e mia për, drejtuar gjendjes civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në lidhje me listën e zgjedhësve, në moment të ngrirë, pra brenda kushteve të akteve që u urdhëruan këto zgjedhje, pra brenda datës 5.7.2024. Në dijenë tuaj çfarë materiali ka ardhur? Ky i kërkuar apo gjendja në momentin që e kanë dërguar?

Znj. M. Çelmeta: Në fakt unë kam informacion që ka ardhur shkresa përcjellëse, ka ardhur dhe një listë në exel (eksel) e inkriptuar me kod për bërjen... Në fakt nuk kam informacion, pasi nga Drejtoria e IT-së m'u tha që duhet të ketë akses vetëm personi që ka bërë kërkesë. Ne e...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Më falni, por kërkesën e bëra për zhvillime procedurale dhe vlerësimi në vijimësi tonën por nga ana tjetër edhe të gjithë palëve të interesuara, partive politike dhe kujt i duhej. Kështu që nuk mendoj që do ketë kaq ristrikt, për pjesën e...

Z. M. Çakaj: Më fal, se po ndërhyj...Pse çfarë problemi ka të... lista e zgjedhësve publikohet, afishohet edhe atje.

Znj. H. Vukaj: Po pra, s'ka ndonjë element sigurie.

Z. M. Çakaj: Po pra, s'ka, nuk bën pjesë në materialet e... që mbrojnë të dhënat personale, lista e zgjedhësve është, publikohet atje...

Znj. H. Vukaj: Nuk është sekret.

Z. M. Çakaj:... në çdo... ose në KZAZ-së ose në KQV.

Znj. M. Çelmeta: Në fakt, lista që na erdhi, erdhi në eksel (exel) dhe erdhi e inkriptuar, me kërkesën e...

Z. M. Çakaj: Po, pra, nuk ka të dhëna, shiko, po themi lista e zgjedhëve, e cila publikohet.

Znj. H. Vukaj: Pra, nuk ka të dhëna sensitive, që ato janë sekret.

Z. M. Çakaj: Pra, lista e zgjedhësve përmban atë përbërës zgjedhor që...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Pra, mua thjesht më duhej gjendja e datës 5 korrik 2024.

Znj. M. Çelmeta: Në formë të atillë na e kanë sjellë...

Znj. H. Vukaj: Deri në momentin e vendimmarrjes.

Znj. M. Çelmeta: ...në formë të atillë dhe ne për efekt të një sigurie të shtuar ne e kthyem materialin në eksel (exel) dhe me një pasuord (password), për të cilën komunikuam bashkë dhe e bëmë gati dhe me shkresë përcjellëse.

Znj. H. Vukaj: Po, por...

Znj. M. Çelmeta: Për brendësinë nuk kam informacion...

Znj. H. Vukaj: ...në përputhje me kërkesën time, së pari? E dyta, në dijeninë tuaj a ekziston, apo keni një raport zyrtar të auditimit që i është bërë këtyre listave dhe nëse po a mund të na e vini në dispozicion një kopje, me qëllim vlerësimi dhe konsolidimin e vendimmarrjes më tej?

Znj. M. Çelmeta: Atëherë, njoftohem që është hedhur një raport i auditit, dje, në faqen tonë zyrtare.

Znj. H. Vukaj: Është pasqyruar...

Znj. M. Çelmeta: Mund ta merrni atje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Znj. H. Vukaj: ... në faqen zyrtare.

Znj. M. Çelmeta: Po, po.

Znj. H. Vukaj: Dakord! Gjithsesi në qoftë se DPGJC-ja nuk ka përmbushur... Unë ende i qëndroj kërkesës që DPGJC-ja të më sjellë listën e datës 5.7.2024.

Znj. M. Çelmeta: Dakord. Do t'ju kthej një përgjigje, mbase sot ose nesër, ose të hënën, më saktë.

Znj. H. Vukaj: Një kërkesë që cilën listë keni sjellë...

Znj. M. Çelmeta: Po, patjetër.

Znj. H. Vukaj: ...dhe më pas të saktësojnë momentin.

Znj. M. Çelmeta: Patjetër!

Znj. H. Vukaj: Edhe do të ngremë një strukturë, ndoshta për ta vlerësuar ne vetë, si të jetë rasti.

Znj. M. Çelmeta: Dakord.

Znj. I. Nano: Mund t'ia përcillni këtë kërkesë përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Dakord! Kolegë keni diçka tjetër jashtë rendit të ditës? Jo, nuk ka.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, lutem shkurtimisht zonja Çelmeta, një përshkrim të aktit dhe të relacionit, për të vijuar me shqyrtimin ne.

Znj. M. Çelmeta: Atëherë vijojmë me relacionin për projektvendimin “Për miratimin e orarit të votimit, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Sikundër referon Kodi Zgjedhor, orari gjatë të cilit hapen qendrat e votimit, i referohet periudha zgjedhore, konkretisht, 15 prill deri me 15 maj dhe 15 tetor deri me 15 nëntor. Duke qenë se zgjedhjet e datës 4 gusht 2024 nuk përkojnë në asnjë prej periudhave zgjedhore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, kërkohet që të përcaktohet nga Komisioni Rregullator se në cilën orë do të hapen dhe mbyllen qendrat e votimit. Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12. 2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet që qendrat e votimit të hapen në orën 7:00 dhe të mbyllen në orën 19:00. Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e orarit të votimit, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Çelmeta! Fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë, ka diçka në parim lidhur me këtë projektvendim? Nëse jo, unë vetëm dy fjalë, sikundër e trajtova dhe pak më herët dhe zonja Çelmeta e theksoi, data e zgjedhjeve 4 gusht 2024, bie jashtë dy periudhave zgjedhore të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Edhe në zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara më herët, ato të 6 marsit 2022 dhe të 24 shtatorit të vitit të kaluar për Bashkinë e Kukësit, kanë qenë ditë zgjedhjesh jashtë dy periudhave zgjedhore, kështu që në varësi të stinës kemi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

miratuar edhe orarin e votimit, duke pasur parasysh një nga dy oraret që parashikon Kodi Zgjedhor. Mirë, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka

Miratohet me 5 vota pro.

Fillojmë duke lexuar shqyrtimin pikë për pikë.

Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, hapen në ora 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.

Kush është dakord? Kush është dakord me këtë përcaktim? Keni diçka zonja Koja për të... Për pikën e dytë? Dakord! Atëherë kush është dakord, kolegë me pikën e parë?

Kush është dakord?


Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka

Me 5 vota pro miratohet. Kalojmë te pika e dytë. Zonja Koja kishit diçka?

Znj. M. Koja: Diçka të vogël në fakt, që po e unifikojmë dhe nëse jeni dakord të vijojmë kështu edhe me vendimet e Rregullatorit: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet...” jo “...në faqen elektronike zyrtare”, por në “...faqen zyrtare të internetit të KQZ-së”. Duke qenë se legjislacioni ka ndryshuar kohët e fundit dhe kjo po përdoret si terminologji e unifikuar, quhet “faqja zyrtare e internetit e institucionit”, thjesht një saktësim të tillë. Në qoftë se për ju është Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Në aspektin teknik, teknikienët e administratës janë më të saktë në këtë fushë dhe në sinkronizim me pjesën tekniko-ligjore. Në qoftë se rri më mirë ashtu, patjetër le të bëhet ashtu! Por ajo që mungon si pikë dy ose pikë tre, kush ngarkohet për zbatimin e këtij akti? Kush i hap ato dyert? Kush merr përsipër që orari të jetë efikas dhe eficient, siç po e përcaktojmë ne? Mungon mekanizmi, organizmi. Mendoj të shtohet.

Znj. I. Nano: Organet e ngarkuar me zgjedhjet, administrata zgjedhore, pra le të gjejmë një...sepse është edhe KZAZ-ja dhe KQV-ja... gjejmë një formulim... Megjithatë, do të votojmë pikën e dytë sipas propozimit të zonjës Vukaj “Për ngarkimin me detyra në zbatimin e këtij...” apo duhet “hyrja në fuqi”, jo është... Jo, është “ngarkimi me detyra” njëherë pastaj “hyrja në fuqi”. Atëherë votojmë shtesën pikë dy “Ngarkimin me detyra...”

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka

Miratohet me 5 vota pro.

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jemi korrekt zonja Koja?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s’ka

Miratohet me 5 vota pro.

Pika 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka

Miratohet me 5 vota pro.

Votojmë dhe në tërësi projektvendimin pasi kemi bërë dy ndërhyrje, një shtesë dhe një ndryshim.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka

Miratohet me 5 vota pro.

Duke qenë se nuk kemi çështje të tjera, apo ka zonja Vukaj? Po!


Znj. H. Vukaj: Më lindi një kërkesë, natyrshëm, në vazhden e vlerësimit të akteve që do të vijnë. Do të doja zonja Çelmeta t'i drejtoheshit thesarit ose degës respektive të thesarit për Prefekturën Vlorë, të na bëjë me dije ose të na pajisë me informacion për listën e punonjësve të administratës së Prefekturës Vlorë.

Znj. M. Çelmeta: Patjetër.

Znj. H. Vukaj: Faleminderit!

Z. M. Çakaj: Më fal, edhe unë kisha diçka. Në fakt, nisur nga që sapo na informoi Sekretarja e Përgjithshme, zonja Çelmeta. Unë i hodha një sy, kështu, të shpejtë raportit të auditit, teknikien, lidhur me listën e zgjedhësve dhe na rezulton që të paktën nga këto të dhëna, sa janë publikuar në faqen zyrtare, rezulton që në ndryshim nga lista e zgjedhësve të vitit 2023, në listën e zgjedhësve të vitit 2024 raporti përmban të dhëna deri në datën 10 korrik 2024, pra votuesit në Bashkinë Himarë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Rezulton që është rritur numri me 252 dhe nga të dhënat e DPGJC-së vërejmë se kanë ardhur me vendbanim në Himarë 311 votues nga bashki të tjera. Pra, nga 2023 në 2024, qenka bërë shumë atraktive Himara! I ka nxjerrë të dhënat dhe me origjinë nga janë transferuar në Himarë, nga të cilët rezultojnë 90 nga Bashkia Tiranë, 68 nga Bashkia Vlorë dhe këtu i mbështes dhe kërkesën e koleges Vukaj lidhur me punonjësit...

Znj. H. Vukaj: Punonjësit e Bashkisë Vlorë.

Z. M. Çakaj: ... po dhe, atëherë të lutem..

Znj. H. Vukaj: Shtoji dhe këto.

Z. M. Çakaj: Referuar raportit paraprak të auditit teknikien rezulton se janë transferuar nga Tirana 90, nga Bashkia Vlorë 68 votues apo persona, nga Bashkia Sarandë 43, nga Bashkia Fier 17, nga Bashkia Dropull 14, nga Bashkia Berat 9, nga Bashkia Lushnje 9, e me radhë. 7 Divjakë, 7 Kurbin, 6 Gjirokastrë, 5 Memaliaj, Përrenjas, Elbasan, Durrës, bile dhe nga Mati, edhe nga Fushë-Arrëzi, edhe nga Poliçani kanë shkuar me vendbanim në Himarë. Kështu që në total janë 311 votues që janë transferuar nga viti 2023 deri në vitin 2024. Ndërkohë që nga viti 2020, 2021 kur kishim zgjedhjet e përgjithshme deri në vitin 2023, nga raporti rezulton që janë pakësuar me 8 persona. Natyrshëm lind pyetja, çfarë e ka bërë kaq atraktive Himarën? Dhe nëse ka mundësi a mund të infomohemi se kur ka ndodhur kjo? Në çfarë periudhe? Nëse nuk shkel, domethënë ndonjë rregull, a mund të informohemi, në çfarë periudhe?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Znj. I. Nano: Duhet të saktësojmë kërkesat që zonja Çelmeta t'ia drejtojë Drejtorisë së Përgjithshme...

Z. M. Çakaj: Po, e qartë.

Znj. I. Nano: ... të Gjendjes Civile dhe atë që zonja Vukaj..

Znj. M. Çelmeta: Më fal, pyetja do t'i drejtohet DPGJC-së?

Z. M. Çakaj: Po, DPGJC-së.

Znj. M. Çelmeta: Për këtë informacion që po kërkonti?

Z. M. Çakaj: Atëherë, nga informacioni, që kemi në raportin e auditit teknikien...

Znj. M. Çelmeta: Po.

Z. M. Çakaj: ...rezulton që të gjithë këta persona janë transferuar nga gjithë këto qytete apo bashki të cilat unë sapo i cilësova, pra 90 Tirana, 68 Vlora, 43 Saranda, 17 Fieri, 14 Dropulli e me radhë dhe pyetja që lind, që pari i bashkohem dhe unë pyetjes së koleges Vukaj...

Znj. H. Vukaj: Dhe kërkesës që duhet ta ripërsërisni, më duhet lista deri me datën 5.

Znj. M. Çelmeta: Deri me datën 5.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Z. M. Çakaj: Datën e dekretit.

Znj. M. Çelmeta: Deri datën e daljes së dekretit, patjetër.

Z. M. Çakaj: ...e para dhe e dyta a mund të informohemi, pa shkelur të dhënat të cilat mbrohen, të dhëna personale e të gjithë këtyre votuesve, por a mund të informohemi se në çfarë periudhe ka ndodhur ky migrim kaq i madh drejt Himarës?

Znj. M. Çelmeta: Po.

Z. M. Çakaj: Nëse mund ta kemi këtë informacion sepse është shumë e rëndësishme kjo në raport me zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie që po zhvillohen në Himarë.

Znj. M. Çelmeta: Po, në rregull.

Znj. H. Vukaj: Ndërsa për Degën e Thesarit, po e ritheksojmë dhe njëherë kërkesë për listën e punonjësve të Bashkisë në Vlorë, të Bashkisë Himarë dhe të Prefekturës Vlorë.

Z. M. Çakaj: Edhe një gjë të fundit...

Znj. H. Vukaj: Pra, listën nominative

Znj. M. Çelmeta: Po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.07.2024*

Z. M. Çakaj: ...që besoj se vlen ta theksojmë, numri i votuesve në vitin... nga raporti rezulton se numri i votuesve në vitin 2023 ka qenë 22 000 më fal të gjej vlerën e saktë, numrin e saktë të votuesve... Ndërkohë nuk e kemi, sapo... Në vitin 2023 në zgjedhjet vendore të vitit 2023 në Bashkinë Himarë ka votuar 22 822 votues, ndërkohë që numri i përgjithshëm, lista përfundimtare, 23 074 del. Pra, rritja me 311 persona në vitin 2024 më rezulton që është diçka më shumë se 10% e numrit të votuesve në raport me vitin 2023. Duke parë dhe rezultatin e vitit 2023 që kishte një diferencë të vogël midis kandidatëve. Ne do të kërkojmë, brenda kufijve ligjore, të hetohet nga administrata e KQZ-së, të merret komunikimi me gjithë institucionet përkatëse se çfarë ka ndodhur, që në raportin e auditit teknikien na rezulton që është rritur numri i votuesve në vitin 2024 me 311, çfarë ka ndodhur, çfarë kanë bërë? Se kur ka ndodhur ky migrim i brendshëm? Vlerësojmë shumë të rëndësishme këto të dhëna. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord! Zonja Çelmeta besoj i keni të qarta kërkesat e kolegëve për informacion.

Znj. M. Çelmeta: Patjetër.

Znj. I. Nano: Kështu që do t'ju lutesha sa më shpejt...

Znj. M. Çelmeta: Sa më shpejt që të jetë e mundur!

Znj. I. Nano: ...sa më shpejt që të dërgoni shkresat përkatëse në institucionet nga kërkohet informacioni. Kolegë, meqë nuk kemi çështje të tjera për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 04

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*